



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 94, datë 17.03.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RAPORT
I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL
TË GJYQTARES

Ekstrakt

E – ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR
ÇDO KRITER VLERËSIMI.

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtarja duke marrë në konsideratë edhe natyrën e çështjes, identifikon dhe analizon faktet e çështjes në mënyrë të detajuar, me qëllim përcaktimin e natyrës së çështjes. Gjyqtarja evidenton në një nënndarje të veçantë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit rrethanat procedurale të rezultuara gjatë hetimit e gjykimit. Në një nënndarje të dytë parashtron faktet penale sipas aktit të njoftimit të akuzës, kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, shoqëruar më pas me ndarjen dhe renditjen e provave respektive, në mënyrë të veçantë për secilin fakt të vlerësuar të rëndësishëm, lidhur me provueshmërinë e elementëve të figurës së veprës penale.

Në çështjet me objekt gjykimi (*seancë paraprake- dërgim në gjyq*), gjyqtarja përcakton natyrën e çështjes dhe fazën procedurale, duke cituar në mënyrë specifike edhe dispozitat procedurale të ndryshuara me ligjin nr. 35/2017, në lidhje me detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake (*nenet 332/ç pika 1, 332/c pika 3, 332/dh pika 1 shkronja ç, nenet 128-130, 179, 256/3 të K.Pr.Penale si dhe nenin 331 në lidhje me nenin 327 pika 2 e K.Pr.Penale*).

Në vendimet e shqyrtuara evidentohet aftësi shumë e mirë e gjyqtares për të identifikuar natyrën e faktit penal objekt gjykimi, në raport me rrethanat e provuara në gjykim. Gjykata,

në evidentimin e faktit penal, i kushton rëndësi analizës së çdo elementi të anës objektive dhe subjektive të veprës penale, analizës së elementëve cilësues të veprave penale për të cilat procedohet. Gjithashtu, në rastet kur ka pasur pretendime për ndryshimin e kualifikimit të faktit penal, gjyqtarja ka analizuar në mënyrë të detajuar këto pretendime, duke argumentuar vlerësimin e gjykatës për pabazueshmërinë e pretendimit të mbrojtjes¹.

Evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi të veçantë identifikimit të ligjit të zbatueshëm (material dhe procedural) mbi çdo fakt të analizuar, jo vetëm duke identifikuar normat ligjore në raport me faktin, por edhe duke dhënë arsyen për zbatimin e normës mbi faktin konkret.

Lidhur me konfliktin e normave, evidentohet të jetë analizuar në mënyrë të detajuar konflikti në dukje i normave të ligjit penal mbi faktin penal objekt akuze, duke u ndalur në mënyrë të veçantë tek neni 28 pika 4 i K.Penal dhe neni 334/1 i Kodit Penal, si formë e veçantë e bashkëpunimit, sikurse është “Grupi i strukturuar kriminal”.

Në raste të veçanta dhe kur ka qenë e nevojshme, gjyqtarja ka identifikuar dhe aplikuar mbi faktet, si ligj të zbatueshëm, edhe normat e konventave ndërkombëtare. Konkretisht, dispozita të Konventës të Kombeve të Bashkuara “Kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope” me qëllim përcaktimin e kuptimit të trafikimit si koncept dhe aplikimit të tij në raport me rrethanat e çështjes, si formë e kryerjes së veprës penale për të cilën procedohet²; dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin e luftimit e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”, me qëllim argumentimin dhe evidentimin e faktit që motivet nuk janë element përbërës të veprës penale³, dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara “Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar”, në lidhje me përkufizimin e grupit të strukturuar kriminal.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin tepër të qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi secilin fakt, citimin dhe analizën e normave respektive, duke evidentuar dhe arsyetuar në rastet kur ka qenë e nevojshme, edhe konfliktin e normave, kryesisht në lidhje me normat e ligjit penal material.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se në vendimet përfundimtare të gjyqtarës identifikohet, citohet dhe analizohet në mënyrë të detajuar norma ligjore konkrete në shërbim të analizës së fakteve dhe konkluzionit të arritur,

¹ Vendimi nr. 5 datë 17.01.2019; Vendimi nr. 68 datë 25.10.2019; Vendimi nr. 16 datë 01.03.2019;

² Vendimi nr. 16 datë 01.03.2019;

³ Vendimi nr. 5 datë 17.01.2019; Vendimi Nr. 68 datë 25.10.2019

lidhur me zbatimin e normës. Në pjesën e vlerësimit të gjykatës, analiza ligjore është e qartë, konkrete dhe në rrjedhë logjike, lidhur me evidentimin e elementëve të veprës/veprave penale për të cilat procedohet.

Në një nga rastet e vëzhguara, evidentohet se gjyqtarja në funksion të analizës për të përcaktuar dhe legjitimuar pjesëmarrësit në proces me cilësinë e viktimave, interpreton kuptimin e ligjit procedural (*nenit 58 pika 2 dhe 4 të K.Pr.Penale në përputhje me nenin 360 të K.Civil mbi rrethin e trashëgimtarëve ligjorë*)⁴. Ky interpretim bëhet duke përdorur edhe direktivën nr.29/2012 të Bashkimit Europian, “Për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimin”. Në përputhje me rrethanat e faktit dhe procedurale të çështjes interpreton nenin 405 në lidhje me nenin 93 të K.Pr.Penale dhe nenin 79/c të K.Penal⁵, për të argumentuar arsyet pse nuk duhet të pranohet kërkesa për të proceduar me gjykimin e shkurtuar. Interpreton dispozitat procedurale në lidhje me njoftimet e akteve të pandehurve (*nenet 139,132, 143 të K.Pr.Penale në lidhje me nenin 15 të Konventës së Këshillit të Europës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale në lidhje me nenin 509/4 të K.Pr.Penale*), për të konkluduar se nuk konstatohen pavlefshmëri absolute apo relative të akteve procedurale. Gjykata ndalet edhe në trajtimin teorik të nocioneve “pavlefshmëri e akteve” dhe “papërdorshmëri e provave”, referuar pretendimeve të mbrojtjes në lidhje me këto dy institute, etj.

Në lidhje me dispozitat e ligjit penal material, evidentohet interpretimi i dispozitave materiale, në funksion të kualifikimit juridik të faktit penal, interpretim ky i bërë në përputhje me rrethanat e faktit dhe provat e shqyrtuara. Interpretimi i dispozitës materiale bëhet jo vetëm në këndvështrim teorik, por duke u ndalur në çdo rrethanë fakti të dalë nga shqyrtimi gjyqësor dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, me qëllim arritjen e konkluzioneve të qarta dhe logjike për ekzistencën e fakteve, autorësinë e veprave penale dhe provueshmërinë tyre, në mënyrë të plotë, duke trajtuar në këtë aspekt, edhe çdo pretendim apo kërkesë të palëve në proces.

Në vendimet përfundimtare në çështjet e themelit, evidentohet përcaktimi i saktë, shumë i qartë, si dhe i kuptueshëm i fakteve të çështjes, identifikimi i normës/normave ligjore konkrete në lidhje me çdo çështje, referimi, analiza dhe interpretimi i tyre në shërbim të arsytimit për çdo fakt që lidhet me provueshmërinë e elementëve të veprave penale për të cilat procedohet. Veçanërisht, në disa nga aktet e analizuara evidentohet zbatimi i parimeve të përgjithshme, të tilla si: parimi “*in dubio pro reo*” (përtej çdo dyshimi të arsyeshëm)⁶, parimi i taksativitetit⁷, parimi i prezumimit të pafajësisë⁸, parimi “*ne bis in idem*” (parimi i gjësë së gjykuar)⁹ dhe parimi i ligjit penal me të favorshëm¹⁰.

⁴ Vendimi nr. 5 datë 17.01.2019;

⁵ Vendimi nr. 5 datë 17.01.2019; Vendimi nr. 68 datë 25.10.2019;

⁶ Vendimi nr. 5 datë 17.01.2019; Vendimi nr. 68 datë 25.10.2019;

⁷ Vendimi nr. 72 datë 24.06.2019;

⁸ Vendimi nr. 72 datë 24.06.2019; Vendimi nr. 42 datë 26.03.2019;

⁹ Vendimi nr. 42 datë 26.03.2019;

Si gjyqtar i seancës paraprake, referuar fazës procedurale të çështjes, bën interpretimin e dispozitave materiale në përputhje me rrethanat e fakteve dhe provave të paraqitura, sipas vlerësimit të gjyqtarit të seancës paraprake. Këtë vlerësim, gjyqtarja e bën për aq sa mund të vlerësohet në seancë paraprake, duke treguar kujdesin që një vlerësim i hollësishëm i përket fazës së gjykimit të çështjes e vlerësimit të provave në kushtet e debatit dhe kontradiktoritetit të gjykimit, pasi në seancë paraprake gjykata limitohet vetëm në verifikimin nëse në situatën në të cilën ndodhen aktet mund të kalohet çështja në gjyq, pa bërë vlerësime thelbësore që i takojnë fazës së gjykimit. Gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale penale të ndryshuara, mbi detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake, në lidhje me konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve procedurale apo papërdorshmërinë e provave, duke cituar edhe *parimin e taksativitetit* në rastin e pavlefshmërisë relative të akteve procedurale.¹¹

Në vendimet e administruara evidentohet aftësia e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut dhe kur është rasti, gjyqtarja i referohet edhe jurisprudencës së Gjykatës së Kasacionit të Italisë, jurisprudencë e huaj, e cila pavarësisht se nuk është burim i së drejtës sonë, i vjen në ndihmë të interpretimit të nocioneve të reja, duke qenë se ndryshimet janë bërë duke pasur për model edhe legjislacionin procedural penal italian.¹²

Gjithashtu, evidentohet përdorimi i Konventave Ndërkombëtare, si Konventa e Këshillit të Europës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale, në shërbim të interpretimit të dispozitave procedurale në lidhje me njoftimet e akteve, Konventën Europiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale, në lidhje me kufizimet dhe hapësirën e shteteve për njohjen ose jo të pasojave të gjësë së gjykuar, Konventën e Kombeve të Bashkuara “Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar”, në lidhje me përkufizimin për grupin e strukturuar, si dhe Konventën e Këshillit të Europës “Për parandalimin e luftimit e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

¹⁰ Vendimi nr. 68 datë 25.10.2019;

¹¹ Vendimi nr. 72 datë 24.06.2019; Vendimi nr. 42 datë 26.03.2019;

¹² Vendimi nr. 42 datë 26.03.2019;

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se në vendimet gjyqësore gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Përdor fjalë të thjeshta dhe të kuptueshme jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i tyre, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjin e posaçëm (*ligji nr. 7975 datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”*) apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme dhe të ndryshme nga ato juridike.

Në përdorimin e instituteve, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim penal, gjyqtarja përdor shpesh termat latinë, por duke sqaruar kuptimin e tyre paraprakisht, si përtej çdo dyshimi të arsyeshëm – *in dublo pro reo*; parimi i gjësë së gjykuar – *ne bis in idem*; mosrëndimi i pozitës së të pandehurit – *reformatio in peius*; zbatimi i ligjit procedural në kohën e gjykimit – *tempus regit actum*; etj.

Nuk evidentohet përdorim i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës. Evidentohet në mënyrë të veçantë në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç). Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë së mendimit

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë, të arsyetimit ligjor në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtarja ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar në hartimin e vendimit, duke evidentuar ndarjet dhe nënndarjet e pjesës së vendimit, me qëllim pasqyrimin e strukturuar të pjesëve të domosdoshme të vendimit gjyqësor, pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Konkretisht, në mënyrë specifike evidentohet se në çështjet e kategorisë “krime”, vendimi gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin. Në

pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishëm në proces. Pjesa përshkruese arsyetuese është e ndarë në seksione dhe paragrafë të cilat janë të emërtuar sipas përmbajtjes së tyre; (i) rrethanat procedurale. Në këtë nënpjesë, gjyqtarja rendit veprimet hetimore të kryera nga ana e organit të akuzës dhe më pas pasqyron vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në seancë paraprake, për të vijuar me kërkesat procedurale që kanë rezultuar gjatë shqyrtimit, të çështjes në themel, si refuzimi apo pranimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar, pezullimi i gjykimit të çështjes etj.; (ii) Rrethanat e fakteve të çështjes, të ndara veç nga provat; (iii) Provat e marra gjatë gjykimit duke paraqitur edhe përmbajtjen e tyre, përveç listimit; (iv). Pretendimet e palëve gjatë gjykimit; (v) Vlerësimi i gjykatës në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij, në përputhje me faktet konkrete, si në lidhje me rrethanat procedurale, ashtu edhe analizën e provave, peshën provuese të tyre, analizën e tyre të integruar me kualifikimin juridik të faktit, caktimin dhe individualizimin e dënimit. Në pjesën dispozitive gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit.

Në çështjet e kategorisë “seanca paraprake-dërgim në gjyq” apo “kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake – caktim mase sigurimi”, konstatohet se vendimi gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin. Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishëm në proces. Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: (i) Rrethanat procedurale; (ii) Rrethanat e fakteve të çështjes; (iii) Provat e marra gjatë gjykimit; (iv) Pretendimet e palëve gjatë gjykimit; (v) Vlerësimi i gjykatës, ku gjyqtarja merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzionin e gjykatës. Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet se në çështjet e kategorisë “seanca paraprake”, vendimet për dërgimin e çështjes në gjyq përmbajnë elementët e parashikuar në nenin 332/e të K.Pr.Penale, i ndryshuar. Nga ana tjetër, konstatohet se në pjesën e dispozitivit të dërgimit të çështjes në gjyq, gjykata parashikon faktin që ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankim, për t’u bërë i kuptueshëm dhe i qartë edhe për mosnjohësit e ligjit, nëse vendimi mund të ankimohet, apo jo.

Gjyqtarja ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, zbaton rregullat e shkrimit ligjor sipas metodës *IRAC*, ku identifikon rrethanat procedurale të çështjes, faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm dhe konkluzionin.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta, në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se arsyetimi i vendimeve përfundimtare të vëzhguara, përgjithësisht ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material penal. Në secilin vendim, duke iu referuar edhe natyrës së çështjes, shtjellohen argumentet e gjykatës në mënyrë logjike, duke u integruar me faktet e provuara në gjykim dhe duke u ndalur në analizën në format e veçanta të bashkëpunimit, kuptimin e trafikimit dhe format e posaçme të tij, në mungesën e rrethanave lehtësuese, etj. Gjyqtarja ndalet dhe analizon në mënyrë shteruese çdo pretendim të ngritur gjatë gjyqimit, si në lidhje me kualifikimin juridik të veprave penale, ashtu edhe pretendimet për pafajësinë apo pretendimet lidhur me papërgjegjshmërinë penale të autorit.

Karakteristikë e arsyetimit të gjyqtarës është ekzistenca e lidhjes logjike të argumenteve, integritetit të rrethanave të faktit në raport me analizën ligjore të dispozitave procedurale dhe materiale, si dhe zbatimi i tyre mbi faktin konkret, në shërbim të të cilit analizohen dispozitat.

Në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i lartë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin penal si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale.

Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e faktit penal objekt shqyrtimi, duke orientuar analizën e koncepteve ligjore, në shërbim të arritjes së konkluzioneve dhe zgjidhjes së çështjes.

Dispozitat ligjore që gjejnë zbatim në çështjen konkrete, jo vetëm referohen ose citohen kur është e nevojshme, por analizohen dhe interpretohen në raport me faktet e çështjes. Në një rast, analiza e dispozitave ligjore mbi norma të ndryshme që krijojnë përshtypjen se janë norma në konflikt me njëra tjetrën, arsyetimi është përqendruar në analizën e kuptimit të tyre me qëllim zbatimin mbi faktin konkret (analiza e bashkëpunimit sipas kuptimit të nenit 25 të K.Penal ose si rrethanë cilësuese në raport me format e veçanta të bashkëpunimit). Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse.

Në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i lartë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtares për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultoni se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda afateve ligjore të parashikuara në K.Pr.Penale, me përjashtim të 10 (dhjetë) çështjeve nga kategoria e “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak” dhe 2 (dy) çështjeve nga kategoria “Seancë paraprake”.

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (12 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon afat ligjor (106 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 11.3 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Konstatohet se në rastin e kërkesës me nr. 7/117 regjistri, datë regjistrimi 09.11.2018, me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq”, është kaluar afati 30 ditor i parashikuar në nenin 332/3 të K.Pr.Penale, me 114 ditë. Rezulton se me vendimin e ndërmjetëm të datës 27.11.2018, gjyqtarja ka vendosur kthimin e akteve në prokurori për të disponuar lidhur me cilësimin juridik të faktit penal. Pas plotësimit të detyrave të lëna nga gjykata, prokurori ka risjellë çështjen në gjykatë në datën 27.03.2019, dhe gjykata ka disponuar me vendim përfundimtar më datë 05.04.2020. Duke llogaritur afatin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, pa përshtirë periudhën në të cilin i është lënë afat prokurorit për të plotësuar detyrat e lëna nga gjykata, rezulton se çështja është gjykuar brenda afatit ligjor, konkretisht, është gjykuar për 27 ditë.

Sa më sipër, çështja do të konsiderohet e përfunduar brenda afatit ligjor, dhe raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor është 11 çështje, me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon afat ligjor, 106 çështje, duke rezultuar se gjyqtarja ka gjykuar 10.3 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “0-10 %”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, me përjashtim të 1 (një) çështjeje nga kategoria e “Krime” dhe 1 (një) çështjeje nga kategoria “Kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake”.

Nga të dhënat statistikore, konstatohet se në tabelën nr. 1, çështja me nr. rendor 5, me nr.2/20/20/121 akti, datë regjistrimi 11.07.2017, përfunduar me vendimin nr. 2, datë 19.12.2019, ka qenë e pezulluar për shkak të mosgjëtes së të pandehurit, për periudhën 30.10.2017 (data e pezullimit të gjykimit nga gjykata) deri në datën 16.11.2018 (data e vendosjes së çështjes në lëvizje nga gjykata, pas përfundimit të afatit të pezullimit). Duke llogaritur afatin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, pa përfshirë periudhën në të cilin çështja ka qenë e pezulluar, rezulton se çështja ka përfunduar për 1 vit 4 muaj e 23 ditë, pra jashtë standardit minimal kohor.

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të standardit minimal kohor (2 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykim (31 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 6.4% të çështjeve në tejkallim të standardit minimal kohor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “0-10 %”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardet minimale kohore për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër ose e barabartë me standardin, për të gjitha kategoritë e çështjeve. Konkretisht:

Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 12.66 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “Krime”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 222.5 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 12 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, është 15.66 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara (137 çështje)¹³, me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik 2019 (136 çështje)¹⁴, pra për periudhën e vlerësimit është 100.73%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “+99%”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar në ligj, është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve. Konkretisht;

Për çështjet e kategorisë “Krime”, koha mesatare e arsyetimit është 4.3 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga nenin 382/3 i K.Pr.Penale.

Për çështjet e kategorisë “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit (*me objekt vleftësimin dhe caktimin e masës së sigurimit apo zëvendësimin e masës së sigurimit*) koha mesatare e arsyetimit është 1.5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 5 ditë, i parashikuar nga neni 249 i K.Pr.Penale.

Për çështjet e kategorisë “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit (*me objekt ekzekutimin e masës së sigurimit-verifikimin e kushteve dhe kriterëve të masës*) koha mesatare e arsyetimit është 1

¹³ Në tabelën nr. 2 janë shënuar me nr. Rendor 117 çështje të përfunduara, por në fakt janë 115 çështje, pasi është bërë kalim nga nr. Rendor 86 tek nr. Rendor 89.

¹⁴ Në tabelën nr. 2 janë shënuar me nr. Rendor 117 çështje të regjistruara, por në fakt janë 115 çështje, pasi është bërë kalim nga nr. Rendor 86 tek nr. Rendor 89.

ditë ose 24 orë, pra më e shkurtër se afati procedural 48 orë, i parashikuar nga neni 248/2 i K.Pr.Penale.

Për çështjet e kategorisë “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit (*me objekt caktim mase sigurimi–jepet menjëherë vendimi i arsyetuar, ose me objekt “lejim, vleftësim apo zgjatje e afatit të përgjimit”*) koha mesatare e arsyetimit është 1.04 ditë, pra, sa afati procedural i posaçëm 24 orë, i parashikuar nga neni 244/1 dhe neni 222/1 dhe 4 i K.Pr.Penale.

Për çështjet e kategorisë “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit (*me objekt ekzekutim letërporosie, informacion për të arrestuarin, zgjatje e afateve të hetimit, etj.*) koha mesatare e arsyetimit është 2.18 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 283/2/3 i K.Pr.Penale.

Për çështjet e kategorisë “Seancë paraprake - dërgim në gjyq”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 2.87 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 10 ditë, i parashikuar nga neni 332/dh, paragrafi 2, i K.Pr.Penale.

Për çështjet e kategorisë “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit”, ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit kështu që referimi do bëhet në afatin procedural të përgjithshëm, të parashikuar nga K.Pr.Penale. Konkretisht, për çështjet e kësaj kategorie, koha mesatare e arsyetimit është 3.66 ditë, më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale.

Për çështjet e kategorisë “Ligji Antimafia”, ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit kështu që referimi do bëhet në afatin procedural të përgjithshëm, të parashikuar nga K.Pr.Penale. Konkretisht, për çështjet e kësaj kategorie, koha mesatare e arsyetimit është 1 ditë, më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë, i parashikuar nga neni 382/2 i K.Pr.Penale.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, për kategorinë “Krime” është 11.4 seanca dhe për kategorinë “Seanca paraprake” është 2.5 seanca, pra në total, numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh është 6.95 seanca.

Konstatohet se pavarësisht numrit të lartë të seancave në çështjet e kategorisë “Krime”, nga ana e gjyqtarës janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të zhvilluar dhe përfunduar procesin në kohë, si dhe janë kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme për zhvillimin e seancave efektive. Shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjykatës, por në funksion të shqyrtimit të çështjeve, konform një procesi të rregullt ligjor, në mënyrë që afati i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve të mos bëhet shkak për cenimin e të drejtave procedurale të palëve në proces.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtarja në të gjitha çështjet e përzgjedhura me short e ka vënë në lëvizje dosjen po atë ditë që caktohet me cilësinë e relatores së çështjes. Gjithashtu, rezulton se ka kryer të gjitha veprimet procedurale, gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara në dosje si: vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, vendimi për pezullimin dhe ndarjen e çështjes, vendimi për sanksionimin me gjobë për avokatin e zgjedhur të të pandehurit, etj.

Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt dhe gjykata rezulton të jetë shprehur me urdhra dhe vendime të ndërmjetëm për çdo kërkesë të palëve ndërgjyqëse, në përputhje edhe me llojin e gjykimit (*kërkesë në fazën e hetimeve paraprake, seancë paraprake, apo gjykim themeli*).

Në përgjithësi, evidentohet se seancat gjyqësore kanë filluar pa vonesa (*pra më pak se 15 minuta*) dhe në ato seanca në të cilat procesi ka nisur me vonesë (*mbi 15 minuta*), nga ana e gjyqtarës është relatuar gjithmonë vonesa dhe po kështu, konstatohet se vonesa është shkaktuar për shkaqe të pavarura nga ana e gjykatës. (*pritja e organit të akuzës, në pritje të të gjitha palëve për t’u paraqitur në gjykim, në pritje të një prej anëtarëve të trupit gjykues i cili ndodhet në një gjykim tjetër, etj.*)

Po kështu, evidentohet se seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio, si dhe pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në procesverbalin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, evidentohet se aktet në dosje janë renditur në mënyrë të rregullt, duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit), brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve gjyqësore është e rregullt dhe dokumentacioni është lehtësisht i aksesueshëm, duke përmbajtur aktin e shortit, urdhrin e formimit të turpit gjykues, urdhër për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, provat e administruara gjatë gjykimit, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe vendimin përfundimtar të gjykatës, CD-ja e regjistrimit audio të seancave gjyqësore, si dhe formulari i shpenzimeve gjyqësore.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykatat më të larta. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata, në përputhje me veprimet procedurale të kryera (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance, vendimet gjyqësore), si dhe aktet e paraqitura nga palët (provat e administruara gjatë gjykimit, diskutimet përfundimtare të palëve). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit. Nuk evidentohet që nga ana e gjyqtarës të ketë shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërbajtjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarës

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjtëti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se me shkresën nr. 1815/1 prot., datë 17.08.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 për gjyqtaren Miliana Muça, nuk është depozituar asnjë ankesë.

Nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarës, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtëtin dhe pritshmëritë e publikut. Nga raporti i ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 182/24 prot., datë 07.07.2020, konkludohet se gjyqtarja nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjtëtit të gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarës

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit, ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se për periudhën 01 janar 2019–31 Dhjetor 2019, është paraqitur vetëm 1 (një) kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës dhe rezulton të jetë pranuar. Po kështu, rezulton se vetë gjyqtarja ka paraqitur 1 (një) kërkesë për heqje dorë, e cila gjithashtu rezulton të jetë pranuar. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, duhet të vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konçiz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, konçize dhe e drejtpërdrejtë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues është “I lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezultojnë asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë

apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtares me koleget, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivelin “Shumë e lartë”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe mendimit të kryetarit të gjykatës se gjyqtarja ka komunikim shumë të mirë e korrekt me administratën gjyqësore, vlerësoj se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe të bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtarja Miliana Muça, përgjatë vitit kalendarik 2019 ka marrë pjesë në 7 (shtatë) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e pjesëmarrëses, konvertuar në numër ditësh 13 ditë. Kohëzgjatje kjo që është brenda kufijve të parashikuar nga 5 deri në 40 ditë në vit, në periudhën një vjeçare të vlerësimit.

Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtarja Miliana Muça, përgjatë vitit kalendarik 2019 nuk ka marrë pjesë në cilësinë e lehtësueses/ekspertes në aktivitetet trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës. Po kështu, lidhur me disponueshmerinë e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë, gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton që gjyqtarja gjatë vitit 2019 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën e vlerësimit dhe për pasojë, nuk mund të vlerësohet me pikë për këtë tregues.

Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikimet ligjore akademike” gjyqtarja pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

NDARJA F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter

Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	391	Shkëlqyeshëm

NDARJA G – PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr. 96/2016, “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe të vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e saj të vazhdueshëm në aktivitetet për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

Kryetare
NAUREDA LLAGAMI

Zëvendëskryetar
MAKSIM QOKU

Anëtar
MEDI BICI

Anëtar
ILIR TOSKA

Anëtare
BRIKENA UKPERAJ

Anëtare
FATMIRA LULI

Anëtare
MARÇELA SHEHU

Anëtar/Reator
ERJON MUHARREMAJ

Anëtar
ALBAN TORO

Anëtar
DRITAN HALLUNAJ

SHTOJCA 1

**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT JANAR – DHJETOR 2019**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtares 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtares 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtares 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES			
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	0-10 %

		3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99 %
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
B. Aftësia e gjyqtares për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë

		kryetarit	
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
C. Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Shumë e lartë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Shumë e lartë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtarës	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtarës	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL			
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose	Nuk ka të dhëna

	trajnimin e gjyqtarëve	institucione të tjera	
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarës 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarës	Nuk ka të dhëna
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarës 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		391	
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES		Shkëlqy	